



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/09 - 0247897-2/dt. 20-08.2025  
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kontratës së Prokurimit Nr. 642-25-4661-1-2-1, Numri i Brendshëm i Prokurimit: 642/25/022/1-2-1, Nr. Protokoli 01/370/03-0037029/25, dt. 25.06.2025, me titull “Furnizimi dhe Montimi i serrave të tipi Tunell sip. 50 m<sup>2</sup> me material përcjellës për fermerë përfitues”, dhe Propozim – Vendimit të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Nr. 01-020/04-0047897/25, dt. 11.08.2025, Kryetari i Komunës sjell këtë:

## V E N D I M

(Për Formimin e Komisionit për Vlerësimin, Pranimin dhe Shpërndarjen e mallit, për projektin “Furnizimi dhe Montimi i serrave të tipi Tunell sip. 50 m<sup>2</sup> me material përcjellës për fermerë përfitues” për vitin 2025)

1. **Formohet** Komisioni për Vlerësimin, Pranimin dhe Shpërndarjen e mallit, për projektin “Furnizimi dhe Montimi i serrave të tipi Tunell sip. 50 m<sup>2</sup> me material përcjellës për fermerë përfitues” për vitin 2025, në këtë përbërje:
  - 1.1. Bedri Bajrami – kryetar;
  - 1.2. Hysnije Mikullovc – anëtare;
  - 1.3. Anita Abazi – anëtare.
2. Komisioni është përgjegjës që të bëjë Vlerësimin, Pranimin dhe Shpërndarjen e mallit siç janë: Furnizimi dhe Montimi i serrave të tipi Tunell me sipërfaqe 50 m<sup>2</sup> me material përcjellës për vitin 2025, në bazë të Kontratës së Prokurimit Nr. 642-25-4661-1-2-1, Numri i Brendshëm i Prokurimit: 642/25/022/1-2-1, Nr. Protokoli 01/370/03-0037029/25, dt. 25.06.2025, me titull “Furnizimi dhe Montimi i serrave të tipi Tunell sip. 50 m<sup>2</sup> me material përcjellës për fermerë përfitues”, dhe për të njëjtët të hartoj Raport me Shkrim duke përshkruar gjendjen faktike, mbarëvajtjen e punës në teren gjatë vlerësimit, pranimin dhe shpërndarjes së mallit te fermerët, të cilin Raport së bashku me Kontratën do t'i dorëzojë Menaxherit të Kontratës, Drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, si dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

3. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë Rregullin Financiare Nr. 01/2013/MF – Shpenzimi i Parave Publike, Kontratën e Prokurimit Nr. 642-25-4661-1-2-1, Numri i Brendshëm i Prokurimit: 642/25/022/1-2-1, Nr. Protokoli 01/370/03-0037029/25, dt. 25.06.2025, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
4. Komisioni i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundim të detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Shtojcë:

1x1 Propozim – Vendimi i DBZHR-së, Nr. 01-020/04-0047897/25, dt. 11.08.2025.

T'i dërgohet:

- 1x1 Kryetari të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës së Prokurimit
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
- 1x1 Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- 1x1 Anëtarëve të Komisionit
- 1x1 Arkivit

